

Übersetzung der Dialoge

Përkthimi i dialogëve

Mësimi 1

Kush je ti?

Në mësimin e parë ne do të rikujtojmë një teknikë, e cila ndihmon për të kuptuar më mirë një gjuhë të huaj. Veç kësaj do t'ju paraqesim edhe njëherë personazhet e kursit të gjermanishtes.

Andreas Schäfer: student në një shkollë gazetarie dhe portier – sportelist në hotelin “Evropa” në Ahen, ku zhvillohet edhe kursi i gjermanishtes.

Ex: një personazh imagjinar femëror

Frau Berger: drejtoreshë e hotelit “Evropa”

Hanna: punëtore e pastrimit në hotelin “Evropa”

Dr. Thürmann: një klient i rregullt i hotelit “Evropa”

Personazhet paraqiten me ndihmën e një gjëze që përmban skena të nxjerra nga pjesa e parë e kursit tonë të gjermanishtes ... me një përjashtim: një grua kërkon të gjejë një teatër, teatrin “Avanti”.

Gruaja: Më falni, ju lutem: ku ndodhet teatri “Avanti”?

Burri: Teatri “Avanti”? Teatri “Avanti”? Hm – nuk e di.

Mësimi 2

Ç'mund të bëj për ju?

Tri skenat e mëposhtme zhvillohen në recepsionin e hotelit “Evropa”. Në skenën e parë një djalosh pyet nëse mund të telefonojë.

Burri: Mirëmëngjes. A ka telefon këtu?

Andreas: Sigurisht.

Burri: Mund të telefonoj?

Andreas: Me gjithë qejf. Telefoni është këtu. Këtu, ju lutem.

Burri: Ju faleminderit. (Djaloshi formon numrin duke mërmëritur shifrat) dy pesë një nëntë zero katër (Bie zilja e telefonit, dikush ngre receptorin nga ana tjetër e linjës).

Gruaja: Beker.

Burri: Schmidt. Mirëdita, zonja Beker.

Në skenën e dytë, Andrea i shpjegon një gruaje pak të moshuar se si mund të shkojë në stacion.

Andreas: Mirëdita.

Gruaja e moshuar: Më falni, mund të më ndihmoni?

Andreas: Me gjithë qejf.

Gruaja e moshuar: E dini si është puna, unë nuk jam prej këtej.

Andreas: Si mund t'ju ndihmoj unë?
 Gruaja e moshuar: Unë kërkoj stacionin e trenit.
 Andreas: Stacioni është fare afër prej këtej.
 Gruaja e moshuar: Shyqyr zotit!
 Andreas: Është krejt e thjeshtë: do të ecni në fillim nga e djathta ...
 Gruaja e moshuar: (përsërit) ... në fillim djathtas ...
 Andreas: dhe pastaj në rrugën e dytë ...
 Gruaja e moshuar: ... rrugën e dytë ...
 Andreas: përsëri djathtas.
 Gruaja e moshuar: (përsërit) përsëri djathtas.
 Ex: Pra, së pari djathtas, pastaj rruga e dytë, përsëri djathtas.
 Gruaja e moshuar: Ju faleminderit.
 Ex: Ju lutem.

Në skenën e tretë, Eksa kërkon disa miq ...

Ex: Më falni, a mund të më ndihmoni?
 Andreas: Më gjithë qejf, zonjë e nderuar.
 Ex: Dëgjoni, unë nuk jam prej këtej.
 Andreas: Ç'mund të bëj për ju?
 Ex: Unë kërkoj ... disa miq.
 Andreas: Ah kështu ... Shkoni në fillim majtas ... pastaj djathtas ...
 pastaj prapë majtas ... pastaj gjithnjë drejt ... drejt ... drejt ...

Mësimi 3 **Ai ndodhet mjaft afër qendrës**

Nje çift kërkon një dhomë në hotel. Për fat të keq, hoteli "Evropa" është i zënë plotësisht. Andrea, sportelisti i hotelit, i propozon çiftit t'i drejtohet nje hoteli tjetër, "Karlshotel"-it.

Andreas: Mirëmbërëma.
 Gruaja: Mirëmbërëma. Ne kërkojmë një dhomë.
 Andreas: Oh, më vjen shumë keq, por nuk kemi më asnjë dhomë.
 Burri: Oh, jo. Ky është hoteli i tretë!
 Andreas: Unë mund t'i telefonoj për ju "Karlshotel"-it. Ai ndodhet fare në qendër.
 Gruaja: E di. Ishim atje. Atje ka shumë zhurmë.
 Andreas: Po hotel "Quelle"? Ishit atje?
 Gruaja: Po. Por është shumë i shtrenjtë.
 Burri: Gjithnjë e pakënaqur je ti!
 Ex: E pakënaqur, e pakënaqur, e pakënaqur ...
 Andreas: Pusho ti!

Meqë të dyja propozimet e bëra nga Andrea nuk u pranuan nga çifti, Andrea mendon t'i drejtohet një hotel-pensionit.

Andreas: Unë mund t'i telefonoj edhe një hotel-pensionit, pensionit "König".
 Gruaja: Po ai, si është?

Andreas: Shumë i qetë. Por jo kaq në qendër.
 Burri: S'ka shumë rëndësi. Ju lutem, telefonojini!
 Gruaja: Një minutë. Si do të shkojmë atje?
 Andreas: Unë mund të porosit për ju një taksì. Edhe autobusi numër 40
 ju çon atje. Ai ndalon fare afër.
 Gruaja: Epo, mirë.
 Andreas: Tani, atëherë, po i telefonoj pensionit.

Mësimi 4 **E pamundur**

Andrea përgatitet të kthehet në shtëpi pas punës në hotelin "Evropa". Është pikërisht çasti kur vjen zonja Berger, drejtoresha e hotelit. Ajo i thotë Andreas se nuk duket fort i kënaqur.

Frau Berger: Tungjatjeta, zoti Schäfer.
 Andreas: Mirëmbërëma, zonja Berger.
 Frau Berger: Oh, keni probleme?
 Andreas: Jo, pse?
 Frau Berger: Nuk dukeni fort i kënaqur.
 Andreas: Kush? Unë?
 Frau Berger: Po, ju. Kush tjetër?
 Ex: Unë jo!
 Frau Berger: Pra, zoti ventrilok, më tregoni si është puna!

Andrea i tregon historinë e çiftit. Zonja Berger i kujton atij se klienti ka gjithnjë të drejtë. (fjalë për fjalë: klienti është mbret.)

Andreas: Ja, sot erdhi një çift: ai ishte fatkeq, kurse ajo e pakënaqur.
 Ex: E pamundur! Ishte e pamundur t'i duroje që të dy.
 Frau Berger: Pa shih, pa shih. Nuk duhet të flisni kështu për klientët. Po kjo është e pahijshme.
 Andreas: Keni të drejtë. Eja, Eks, do të kthehemi në shtëpi.
 Frau Berger: Aha, zëri juaj i dytë ka një emër?
 Ex: Vetëkuptohet!
 Frau Berger: Epo, mirë. Ju e dini, veç: klienti ka gjithnjë të drejtë. (origi. klienti është mbreti.)
 Ex: Unë jam mbreti.
 Andreas: Jo, ti je mbretëresha.

Në fund të emisionit, Eksa largohet duke thënë:

Ex: Dëgjuesja është mbretëresha.

Mësimi 5

Një autobus nuk mund të jetë i këndshëm!

Eksa dhe Andrea janë në shtëpinë e Andreas. Eksa arrin ta bindë Andream të luajë me të.

Ex: Andrea, a bëjmë një lojë?
Andreas: Ah, Eks, jam kaq i lodhur ...
Ex: Po është fare e thjeshtë.
Andreas: Epo, mirë.

Në gjëzën e parë, Andrea duhet të gjejë se kush fshihet pas përemrit *erai*.

Ex: Pra, gjeje! Ai është mjek.
Andreas: Kush?
Ex: Ai!
Andreas: Një burrë.
Ex: E saktë!

Në gjëzën e dytë, Andrea duhet të gjejë se kush mund të jetë *i këndshëm*.

Ex: Mirë, atëherë, gjeje! Ai është i këndshëm!
Andreas: Autobusi numër 40.
Ex: Gabim! Një autobus nuk mund të jetë i këndshëm.
Andreas: Okej, okej – një burrë.
Ex: E saktë!

Në gjëzën e tretë, Andrea duhet të gjejë atë që mund të jetë *elegante*.

Ex: Mirë, atëherë, gjeje! Ajo është elegante.
Andreas: Një grua!
Ex: Gabim!
Andreas: Si kështu? Një grua mund të jetë elegante, apo jo?
Ex: Po, por vazhdo të supozosh.
Andreas: Një shishe.
Ex: Kjo vërtet jo.
Andreas: Mbase ... një franceze.
Ex: E saktë.

Në gjëzën e katërt, Andrea duhet të gjejë se kush mund të jetë *interesant*.

Ex: Pa gjeje! Është interesant(e)
Andreas: Një lojë.
Ex: Gabim.
Andreas: Një libër.
Ex: Gabim.
Andreas: Pse? Një libër mund të jetë interesant.
Ex: Po, por unë mendoj gjë tjetër.
Andreas: Një çift.
Ex: Gabim.
Andreas: Atëhere, s'e di.

Ex: Një hotel.
 Andreas: Jo, një hotel nuk mund të jetë interesant.
 Ex: Si jo!
 Andreas: Jo! Njerëzit e një hoteli mund të jenë interesantë.
 Ex: Edhe një hotel!
 Andreas: Jo! Dhe tani e kam radhën unë!

Në gjëzën e fundit është Eksa që duhet të përgjigjet. Ajo nuk e vë re se personi që duhet të gjejë është ajo vetë.

Andreas: Pra, gjeje. Ai është i pasjellshëm.
 Ex: Unë s'e njoh atë.
 Andreas: Ai është kurioz.
 Ex: Nuk e njoh.
 Andreas: Ai është i padukshëm.
 Ex: Unë nuk e njoh.
 Andreas: Ajo është e padukshme.
 Ex: Tani: ai apo ajo?
 Andreas: Unë të pyes ty: 'ai', 'ajo' apo 'ai, ajo' (jofrymore) është e padukshme?
 Ex: Unë s'e di.
 Andreas: Ti je vitore apo magjistare?
 Ex: Unë jam unë.

Mësimi 6

Ndoshta ajo ka nevojë për ndihmë

Hanna do të dijë se kush rri në dhomën 15, sepse ajo dëgjon një zë të fortë që vjen nga kjo dhomë. Mirëpo ajo e di se klientja është vetëm në dhomë.

Hanna: Tungjatjeta, Andrea!
 Andreas: Mirëdita, Hanna. Si kalon?
 Hanna: Mirë! (me zë të ulët) Më thuaj, kush rri tani në dhomën 15?
 Andreas: Zonja Vimer. Po, pse?
 Hanna: Ajo flet gjithnjë me zë kaq të lartë ... por ajo është vetëm fare. Ja, dëgjoje!

Hanna dhe Andrea vënë veshin në derën e zonjës Vimer. Zonja Berger, drejtuesja e hotelit, vjen papritur. Zonja Vimer është aktore. Ajo po mëson rolin e saj.

Zonja Vimer: nicht! : Nein.
 da! : Nein.
 hier! : Nein!
 hinauf! : Nein!
 hin! : Nein. Nein. Nein.
 hilfe? : Ja!
 hilfe? : Ja!
 hilfe? : Ja! (heshtje, pauzë)

Hanna: Ndoshta ajo ka nevojë për ndihmë?
 Andreas: Pse s'e pyet?

Hanna: Po atje është varur shënimi: Ju lutem, mos më shqetësoni!

(Ndërkohë vjen zonja Berger)

Frau Berger: Atëherë mos e shqetësoni!

Hanna: Por si është puna?

Frau Berger: Zonja Vimer është aktore.

Hanna: Aha, kështu qenka puna! Atëherë çdo gjë është e qartë. Por kur mund t'ia pastroj unë dhomën?

Andrea kthehet në recepsion, ku e pret një zotëri, që ka takim me zonjën Vimer.

Andreas: Mirëdita! A mund t'ju ndihmoj?

Burri: Unë kam takim me zonjën Vimer.

Andreas: Po, zonja Vimer, dhoma 15. Po i telefonoj menjëherë.

(Andrea telefonon, por askush nuk përgjigjet.)

Më vjen keq. Ajo nuk përgjigjet.

Burri: Nuk e kuptoj.

Andreas: Unë nuk mund ta shqetësoj zonjën Vimer tashti. Ndoshta dëshironi të prisni?

Burri: S'e di, s'e di ... Oh – i thoni zonjës Vimer, se do ta marr në telefon më vonë.

Mësimi 7

Avioni im nisat në orën nëntë

Një klient pak nervoz dëshiron të porositë një taksì për të shkuar në aeroportin e Këlnit të nesërmen në mëngjes. Andrea e pyet se për në ç' orë duhet ta porositë taksinë.

Burri: Ah, lejohet njëherë të pihet cigare këtu?

Andreas: Natyrisht, mund të pini. Ja një taketuke. Çfarë mund të bëj për ju?

Burri: Mund të më porositni një taksì? Për nesër në mëngjes, herët.

Andreas: Me gjithë qejf. Por për kur?

Burri: Pra, aeroplani im nisat në orën nëntë. Sa kohë i duhet taksisë?

Andreas: Rreth një orë.

Burri: (llogarit kohën duke murmuritur) Aha, një orë: unë do të doja të isha atje në tetë e gjysmë ... një orë rrugë ... pra, në shtatë e gjysmë.

(me zë të lartë) Ma porositni taksinë për në orën shtatë, ju lutem!

Andreas: Dakord!

Ekxa e dëgjoi dialogun dhe e imiton burrin – duke e nervozuar shumë Andream.

Ex: A mund të këndohet këtu?
Andreas: Jo, nuk mundesh.
Ex: A mund t'ju shqetësoj këtu?
Andreas: Eks, të lutem, pusho tani!

Ndërkohë, një çift vjen në receptionin e hotelit. Çifti dëshiron ta zgjojnë të nesërmen në mëngjes, në shtatë e një çerek.

Gruaja: Mirëmbërëma.
Andreas: Mirëmbërëma.
Gruaja: A mund të na zgjoni nesër në mëngjes herët?
Andreas: Me gjithë qejf. Po kur?
Burri: Në shtatë e një çerek.
Andreas: Në rregull. Do t'ju zgjoj në shtatë e një çerek.
Gruaja: Ju faleminderit.
Andreas: Natën e mirë.

Mësimi 8

Këtë s'duhet ta bësh!

Andrea është në dhomën e tij: po dëgjon muzikë duke ngrënë darkë, ndërsa bie telefoni. Megjithëse ai e ndalon Eksën të ngrejë receptorin, ajo shkon te telefoni.

Ex: Andrea, po bie telefoni.
Andreas: (me gojën plot) Po, e dëgjoj!
Ex: Ta ngre receptorin?
Andreas: Jo! Këtë s'duhet të bësh. Po shkoj vetë.
Ex: (ngre receptorin) Alo, ju flet shtëpia e Sheferit. Andrea? Është këtu. Ta thërras?
Andreas: (ia rrëmben Eksës receptorin nga duart) Andrea Shefer.

Ajo që po telefonon është nëna e Andreas. Ajo i thotë Andreas se dëshiron të vijë në fundjavë për ta parë.

Frau Schäfer: Mirëmbërëma, biri im.
Andreas: Alo, mama. Si je?
Frau Schäfer: Faleminderit, mirë. Më thuaj: kush ishte kjo?
Andreas: O, një mikeshë.
Frau Schäfer: Ashtu? Duhet të na e prezantosh patjetër.
Andreas: Si, të lutem?
Frau Schäfer: Mirë, nuk doja të thosha këtë. Dëgjo, ne duam të vijmë për një vizitë.

Andrea duhet të punojë të shtunën, por prindërit e tij do të vijnë në Ahen në orën një. Në këtë kohë edhe Andrea e ka mbaruar punën.

Andreas: Bukur. Po kur?
Frau Schäfer: Tashti, në këtë fundjavë.
Andreas: Më vjen keq. Të shtunën mua më duhet të punoj.
Frau Schäfer: Deri kur duhet të punosh?

Andreas: Deri në orën një.
 Frau Schäfer: Mirë, nuk prish punë. Pra, ne do te vijmë të shtunën. Në orën një jemi atje.
 Andreas: Okej. Mirupafshim të shtunën.

Mësimi 9

Për mua – banane!

Andrea sheh në frigoriferin e tij për të caktuar se ç' duhet të blejë. Ai konstaton se frigoriferi është fare bosh.

Andreas: (shfryn) Bosh! Krejtësisht bosh.
 Ex: Andrea, ç'ka ndodhur? Je shumë i zemëruar?
 Andreas: Po! Jo! Frigoriferi është prapë bosh.
 Ex: Atëherë, ti duhet të shkosh për të blerë.
 Andreas: Këtë e di vetë! Qetësi, tani!

(Andrea bën një listë të ushqimeve që duhet të blejë: ai flet me vete ...)

Me një fjalë: më duhen bukë dhe gjalpë.
 Ex: Bukë dhe gjalpë, djathë dhe sallam.
 Andreas: Po, djathë dhe sallam – dhe fruta.
 Ex: Për mua – banane! Të lutem!
 Andreas: Të shohim. Po tani eja! Duhet të shkojmë të psonisim.

Andrea shkon në një supermerkatë dhe blen djathë e sallam te një shitëse.

Shitësja: Mirëmbërëma. Çfarë dëshironi?
 Andreas: Unë dua pak sallam.
 Shitësja: Po sa?
 Andreas: 150 gramë.
 Shitësja: Dëshironi gjë tjetër?
 Andreas: Po, një copë djathë.
 Shitësja: Po çfarë lloj djathi dëshironi?
 Andreas: Djathë mali, ju lutem.
 Shitësja: Ndonjë gjë tjetër?
 Andreas: Jo, këto janë të gjitha.
 Ex: (me ngazëllim) Ullinj! Ka ullinj! A mund ta provoj një?
 Shitësja: Ju dëshironi edhe ullinj?
 Andreas: Jo, faleminderit shumë.
 Shitësja: (me zë të ulët, me vete) E çuditshme, e çuditshme.

Mësimi 10

Ti gjithnjë do të dish gjithçka

Prindërit e Andreas shkojnë të kërkojnë të birin në hotel. Ata njihen kështu me zonjën Berger, drejtoreshën e hotelit.

Andreas: Tungjatjeta, ja ku erdhët më në fund!
 Ex: Kush erdhi, ore?

Andreas: Prindërit e mi. Dhe tashti rri urtë!
Frau Schäfer: Mirëdita, bir.

(Ata përqafohen)

Herr Schäfer: Mirëdita, Andrea!
Andreas: Mirëdita, baba. Si shkoi udhëtimi?
Frau Schäfer: Mirë, faleminderit. Nuk patëm ndonjë problem.
Andreas: Bukur. Unë jam gati. Shkojmë?

(Zonja Berger vjen dhe bashkohet me ta.)

Frau Berger: Mirëdita!
Andreas: Këta janë prindët e mi. Dhe kjo është zonja Berger, shefja ime
Frau Schäfer: Jemi shumë të gezuar, zonja Berger. Shpresoj se Andrea im nuk ju krijon ndonjë problem.
Frau Berger: Jo. Ai di të bëjë çdo gjë. Ai është portier, gazetar, ventrilok.
Frau Schäfer: Çfarë? Ti je ventrilok?
Andreas: Nuk do të nisemi?

Zonja Shefer zbulon në hollin e hotelit një fotografi të familjes Berger. Kjo e nxit zonjën Shefer të flasë me zonjën Berger për familjen e saj.

Frau Schäfer: Nuk dua të ndërhyj në sferën tuaj private, por kjo sigurisht është familja juaj, apo jo?
Frau Berger: Po, tamam. Këta këtu prapa janë vëllai dhe motra ime. Dhe kjo – jam unë.
Frau Schäfer: Kjo duket menjëherë. Edhe vëllai dhe motra juaj në Ahen jetojnë?
Frau Berger: Jo. Motra jeton në Mynih. Ajo është martuar atje.
Frau Schäfer: Po vëllai?
Frau Berger: Ai është në Frankfurt.
Frau Schäfer: Po prindërit tuaj? Në Ahen janë?
Frau Berger: Jo. Ata kanë vdekur, të dy.
Frau Schäfer: Oh, më vjen keq.
Andreas: Ti do gjithnjë të dish gjithçka.
Frau Berger: Nuk prish punë.

Mësimi 11

Sikur të shkonim në teatër?

Andrea ndodhet me prindërit e vet në një kafe të vogël të Ahenit. Ata bisedojnë se çfarë do të bëjnë pasdite.

Herr Schäfer: Ç'do të bëjmë sot?
Frau Schäfer: Sot pasdite dua të shkoj patjetër për të blerë disa gjëra.

Andreas: Për të blerë?
 Frau Schäfer: Po, ka ulje çmimesh!
 Andreas: Ke të drejte. Po ti, baba?
 Herr Schäfer: Unë do të doja të shkoja në muzeun e gazetarisë.
 Frau Schäfer: Edhe katedralen do të na pëlqente natyrisht ta shihnim.
 Ex: Kurse unë dua të shkoj në diskotekë.
 Andreas: Eksa, rri urtë!
 Frau Schäfer: Ah, kjo ishte padyshim mikësja jote. Po ku është ajo?

Andrea propozon që të takohen në mbrëmje, në orën gjashtë, për të ngrënë së bashku dhe ndoshta për të shkuar pastaj në teatër.

Andreas: Mirë, te katedralja mund të shkojmë dhe nesër. Kurse muzeu i gazetarisë është i hapur vetëm të shtunave.
 Frau Schäfer: Edhe dyqanet, vetëm sot janë të hapura.
 Herr Schäfer: Kjo është e vërtetë.
 Andreas: Unë kam një propozim: ti, mama, shko të psonisësh. Unë do të shkoj me babanë në muzeun e gazetave. Dhe në orën gjashtë shkojmë bashkë të hamë.
 Frau Schäfer: Po pastaj? Ku do të shkojmë më vonë?
 Andreas: Ndoshta në teatër?
 Herr Schäfer: Po. Është ide e mirë.
 Frau Schäfer: Ç' mundësi të tjera ka përveç kësaj?
 Andreas: Ja, le të shohim këtu në gazetë.

Mësimi 12

Me studimet çdo gjë ecën mirë

Zonja Shefer shkon të psonisë. Andrea mbetet edhe disa çaste me babanë në kafe. Ata diskutojnë me njëri-tjetrin.

Frau Schäfer: Pra, mirupafshim më vonë.
 Andreas: Shëndet!
 Herr Schäfer: Mirupafshim në orën gjashtë!
 (i drejtohet Andreas)
 Atëherë, si po kalon?
 Andreas: Falemnderit, gjithçka në rregull. Po ju?
 Herr Schäfer: Mamaja është shumë mirë.
 Andreas: Po ti?
 Herr Schäfer: Edhe unë mirë. Po kam disa probleme.
 Andreas: Probleme?
 Herr Schäfer: (qesh) Po, kam probleme ... me kompjuterin.
 Andreas: Ti ke kompjuter? Unë sigurisht mund të të ndihmoj.
 Herr Schäfer: Ashtu mendon ti?
 Andreas: Sigurisht.

Në pjesën e dytë të bisedës, zoti Schäfer e pyet të birin se si ecën me studimet dhe me punën e tij.

Herr Schäfer: Po ti, Andrea? Si ecin studimet e tua?
 Andreas: Me studimet çdo gjë ecën mirë.

Herr Schäfer: Por çfarë po bën tashti?
 Andreas: Do të bëj së shpejti një reportazh për Ahenin.
 Herr Schäfer: Oh, sa mirë! Do të na e dërgosh atëherë reportazhin?
 Andreas: Sigurisht!
 Herr Schäfer: Si ia çon me punën?
 Andreas: Mirë! Puna më pëlqen.
 Herr Schäfer: Po me zonjen Berger?
 Andreas: Ajo është vërtet shumë e sjellshme.
 Herr Schäfer: Kështu mendoj edhe unë.
 Andreas: Sikur të shkonim tani në muzeun e gazetave?
 Herr Schäfer: Po, me kënaqësi.

Mësimi 13

E keni edhe në ngjyrë të zezë?

Zonja Shefer ndodhet në një supermerkatë që është plot me njerëz, sepse ka ulje çmimesh. Shumë roba shiten aty me çmim të reduktuar.

Frau Schäfer: Uh, qenka plot!
 (Lajmërim ne
 altoparlant): Të dashur klientë! Tërheqim vëmendjen tuaj për ofertën speciale në katin përdhes: Bluza – vetëm për katër marka!

(Dëgjojen lëvizje te klientëve)

Burri: Ku mund të paguaj?
 Gruaja e parë: Të pëlqen kjo?
 Gruaja e dytë: Ma trego njëherë!
 (Lajmërim në
 altoparlant): Të dashur klientë. Tërheqim vëmendjen tuaj për ofertën speciale në katin përdhes!
 Pulovra – vetëm për dhjetë marka!
 Burri: Ku është arka këtu?
 Frau Schäfer: (me vete) Jo – për mua ka shumë njerëz.

Zonja Shefer ngjitet në katin “Konfeksione për gra”, ku shitja bëhet normalisht, pa ulje çmimesh. Ajo kërkon një fund, por nuk ka një ide të qartë se si duhet të jetë ky fund.

Frau Schäfer: Mund të më ndihmoni? Dua një fund.
 Shitësja: Po, urdhëroni. Çfarë mase?
 Frau Schäfer: 44.
 Shitësja: Ç’ngjyrë?
 Frau Schäfer: Çfarë ngjyrash keni ju këtu?
 Shitësja: Shikoheni! Ja një i verdhë. Është ngjyra e re për modën e vjeshtës.
 Frau Schäfer: Oh, jo, e verdha nuk më pëlqen! Keni në ngjyrë të zezë?
 Shitësja: Një minutë – më vjen keq, kemi vetëm numër 42.
 Frau Schäfer: Ai sigurisht është shumë i vogël.
 Shitësja: Provoheni njëherë! Atje prapa është kabina e provës.

Zonja Shefer e provon fundin. Ai është vërtet shumë i vogël.

Frau Schäfer: Jo, është shumë i vogël.
Shitësja: Sa keq!
Frau Schäfer: Ju faleminderit. Mirupafshim!
Shitësja: Mirupafshim!

Mësimi 14

Kjo duhet të jetë shumë interesante

Andrea dhe prindërit e tij mendojnë të shkojnë në teatër për të parë një pjesë të Boto Shtrausit të titulluar “Groß und klein” (I madh dhe i vogël). Ata vrasin mendjen se ç’do të thotë ky titull.

Andreas: Në teatrin e qytetit luhet një pjesë e Boto Shtrausit: “I madh dhe i vogël”.

Herr Schäfer: Kjo duhet të jetë shumë interesante.

Frau Schäfer: Dhe ç’do të thotë kjo: “I madh dhe i vogël”?

Ex: Kjo do të thotë: si janë njerëzit? Të mëdhenj apo ...

Frau Schäfer: (e indinjuar) Si janë njerëzit? Të mëdhenj apo të vegjël?

Andreas: Po jo! Nuk do të thotë këtë!

Frau Schäfer: (ende e indinjuar) Jo, pra vërtet, kjo nuk më intereson.

Herr Schäfer: “I madh dhe vogël” kjo do të thotë, megjithatë: Si janë njerëzit?

Ex: Të mëdhenj apo të vegjël?

Herr Schäfer: Si mendojnë ata?

Ex: Shumë apo pak?

Herr Schäfer: Si veprojnë ata?

Ex: Mirë apo keq?

Frau Schäfer: Dhe kjo do të jetë interesante? Mua ky zë më duket interesant.

Andrea dhe prindërit e tij bien dakord që të shkojnë të shohin “Dreigroschenoper” (Opera për dy grosh) të Bertolt (Bert) Brehtit.

Andreas: Ç’mendoni për këtë? Në teatrin e operas jepet “Opera për dy grosh”.

Ex: Ç’do të thotë “Opera për dy grosh”?

Andreas: Për dy grosh – do të thotë me çmim të lirë.

Frau Schäfer: Me kë flet ti?

Ex: Me mua.

Andreas: Eksa, të lutem hesht.

Frau Schäfer: Unë nuk të kuptoj, Andrea. Ti je vërtet ventrilok?

Andreas: Jo. Do të ta sqaroj më vonë. Mirë, atëherë, do të shkojmë të shohim “Operën për dy grosh”?

Herr Schäfer: Po, me gjithë qejf.

Andreas: Ju me siguri e njihni këngën e Mackie Messer (Meki Thika)?

Ex: (këndon këngën e Meki Thikës)

Mësimi 15

Një burrë me emrin Meki Thika

Andrea telefonon në opera për të porositur bileta për shfaqjen “Opera për dy grosh”.

- Gruaja: Mirëmbërëma.
Andreas: Mirëmbërëma. Jam Shefer. A ka akoma bileta për “Opera për dy grosh”?
Gruaja: Për kur?
Andreas: Për sonte në darkë.
Gruaja: Po, por vetëm 30 marka.
Andreas: Unë do të marr tri bileta.
Ex: Katër!
Gruaja: Si, ju lutem? Doni tri apo katër bileta?
Andreas: Jo, unë dua vetëm tri.
Gruaja: Si e kishit emrin?
Andreas: Shefer.
Gruaja: Duhet të vini t'i merrni biletat përpara orës shtatë e gjysmë.
Andreas: Po, ashtu do të bëj. Mirupafshim.

Andrea shpjegon subjektin e kësaj opere.

- Andreas: Me një fjalë: në “Operën për dy grosh” ngjarjet zhvillohen në Londër. Në të flitet për hajdutë dhe lypësa. Kryetari i tyre është një burrë që quhet Meki Thika. Mjafton emri që ta kuptosh: Meki Thika ka një thikë.
Ex: Vetëkuptohet.
Andreas: Kënga e parë flet për veprat e ulëta të Meki Thikës. Një njeri vdes. Ky njeri kishte para. Por paratë janë zhdukur. Dhe këto para tani i ka Meki Thika.
Ex: Hajduti!

Mësimi 16

Këtë e dëgjo dikush

Andrea u tregon prindërve të tij si u njoh me Eksën.

- Andreas: Ju me siguri nuk do ta besoni tregimin tim. Pra, kjo ka ndodhur kështu: unë isha në shtëpi dhe po lexoja një libër, librin mbi Shpirtrat e Mirë të Këlnit. Ju e dini se ishin ata që bënin punën e njerëzve gjatë natës. Unë e lexova këtë histori dhe fillova të ëndërroj ...
Dhe atëhere thashë me zë të lartë: “Sikur të kisha edhe unë një ndihmë si kjo!” Por pastaj, pastaj thashë me vete: “Eh, (psherëtimë) kjo vetëkuptohet që nuk është e mundur.”
Frau Schäfer: Dhe pastaj?
Herr Schäfer: Shëët!
Andreas: Këtë e dëgjo dikush!

Frau Schäfer: Kush, pra?
Andreas: Eksa! Dhe ajo tha:
Ex: Tungjatjeta! Tungjatjeta! Ja ku jam.

Prindët e Andreas reagojnë në mënyrë jo të njëjtë: zonja Shefer hutohet pak, zoti Shefer do të dijë nëse Eksa e ndihmon Andrean.

Ex: Tungjatjeta! Tungjatjeta! Ja ku jam.
Frau Schäfer: Po ku je? Ku është ajo? Unë s'e shoh.
Ex: Unë jam e padukshme.
Frau Schäfer: Dhe të gjitha këto ne duhet t'i besojmë?
Ex: Vetëkuptohet.
Herr Schäfer: Mirë, Andrea, a të ndihmon ajo?
Andreas: (kruan fytin i pasigurt)
Ex: Po, shumë!

Mësimi 17

Nga vjen emri Ahen?

Andrea po bën një detyrë të kursit të tij të gazetarisë: ai interviston njerëz në rrugë. Ai bën sondazhe, nëse njerëzit e dinë se nga vjen emri Ahen dhe se ç'kuptim ka ai.

Andreas: Më falni, ju lutem: doja t'ju pyesja për diçka.
Kalimtari i parë: Më vjen keq, unë nuk jam prej këtej.
Andreas: Më falni, mund t'ju pyes për diçka?
Kalimtari i dytë: Po, çfarë pikërisht?
Andreas: Si mendoni ju: ç'kuptim ka emri *Ahen*?
Kalimtari i dytë: Ahen? Ç'doni të thoni?
Andreas: Po, nga vjen emri *Ahen*?
Kalimtari i dytë: Jo, këtë s'e di. Po ju, e dini?

Personi që vjen pas është një kalimtare e re.

Andreas: Mirëdita. Kam një pyetje.
Kalimtarja e parë: Po, urdhëroni?
Andreas: Ç'kuptim ka emri *Ahen*?
Kalimtarja e parë: S'e kam idenë. Dhe kjo s'më intereson.

Është një çift disi i moshuar ai që di të përgjigjet.

Andreas: A mund t'ju pyes se ç'kuptim ka emri *Ahen*?
Kalimtari i tretë: Ahen, Ahen?
Andreas: Po, nga vjen emri *Ahen*?
Kalimtari i tretë: Më parë këtu kanë qenë romakët.
Andreas: E saktë.
Kalimtarja e dytë: Dhe në Ahen më parë ka pasur burime uji.
Kalimtari i tretë: Tamam. Dhe fjala për ujë ka qenë *aqua*.
Kalimtari i tretë: Atëherë, emri *Ahen* vjen nga *Aqua* dhe do të thotë ujë?
Andreas: Po, *aqua* ka qenë emri i parë për Aachen (Ahen).

Kalimtari i tretë: Prit – dhe më vonë këtu kanë qenë fiset gjermanike.
Andreas: Dhe ata i dhanë Ahenit emrin *abba*.
Kalimtari i dytë: Dhe kjo do të thotë gjithashtu “ujë”?,
Andreas: Po!

Mësimi 18

Këtë e di prej tij

Andrea bën me prindërit një shëtitje nëpër Ahen. Në qytet ka shumë shatërvanë, si për shembull, shatërvani “Elize”, uji i të cilit mund të pihet.

Herr Schäfer: Andrea, do të na e tregosh qytetin?
Ex: Oh, posi!
Andreas: (duke luajtur rolin e gidës) Mirë, ju e dini: Aheni është qyteti i ujit.
Ex: Kjo vetëkuptohet, Ahen do të thotë ujë.
Frau Schäfer: Nga e di ajo këtë?
Ex: Këtë e di prej tij, prej Andreas.
Frau Schäfer: Por Aheni, megjithatë, nuk është në breg të detit.
Andreas: Kjo është e vërtetë, por Aheni ka shumë shatërvanë!
Frau Schäfer: A mund të pihet uji?
Andreas: Normalisht jo. Këtu është shatërvani “Elize” që nga viti 1827.
Ex: Ujët e tij është i pishëm.
Frau Schäfer: Po ai ka një shije shumë të keqe!
Andreas: Nga e di ajo këtë?
Frau Schäfer: Ia kam thënë unë.
Andreas: (provon ujin) Ptu ... ka vërtet shije të tmerrshme.
Andreas: Por është shumë i shëndetshëm.

Të tre enden akoma në rrugët e qytetit ndërsa Andrea u tregon katedralen e shquar të Ahenit, ku perandori Karli i Madh dikur kishte ngritur rezidencën e tij.

Andreas: Urdhëroni – ja edhe katedralja!
Herr Schäfer: Këtu ka qenë më parë rezidenca e Karlit të Madh, apo jo?
Andreas: Pikërisht. Karli i Madh këtu e kishte rezidencën e vet.
Ex: Karli i Madh?
Andreas: Ai ka qenë perandor.
Ex: Po pse ishte në Ahen ai?
Andreas: Aheni ka shumë burime të ngrohta. Dhe dikur kjo ishte shumë e këndshme.
Ex: Do të m'i tregosh burimet ndonjë herë?
Andreas: Okej, Eks, këtë ta premtoj.
Frau Schäfer: Dhe tani unë dua të hyj në katedrale.
Andreas: Mirë – tani këtë do të bëjmë.

Mësimi 19

Si flitet me një perandor?

Andrea bën një intervistë imagjinare me Karlin e Madh, kurorëzuar perandor në vitin 800 në Romë.

- Ex: Do të bësh intervistë me një perandor?
Andreas: Po, por të lutem rri urtë!
Ex: Je nervoz?
Andreas: Sigurisht. Si flitet me një perandor?
Zeri: Kujdes. Emisioni fillon.
Andreas: Mirëdita, të dashur dëgjuese dhe dëgjues. Sot kemi një mik në studion tonë: Karli i Madh është këtu! I urojmë përzemërsisht mirëseardhjen.
Karli i Madh: Mirëdita, djalosh.
Andreas: Ju sapo u kthyet nga një udhëtim?
Karli i Madh: Po, unë isha në Romë.
Andreas: Tani ju jeni edhe perandor ...
Karli i Madh: Është një nder i madh për mua.
Andreas: Gjermanët ju quajnë "Karl der Große", Karli i Madh.
Karli i Madh: Ashtu? Është padyshim përkthimi i Carolus Magnus?
Andreas: Pikërisht. Dhe francezët ju quajnë "Charlemagne".
Ex: Dhe italianët "Carlo Magno".
Karli i Madh: Çfarë thatë, ju lutem?

Andrea i tregon Karlit të Madh se edhe sot akoma ai është shumë i famshëm në Ahen. Ekziston edhe një shatërvan (Karlsbrunnen) dhe një çmim (Karlspreis) që mbajnë emrin e tij.

- Andreas: A ju pëlqen Aheni?
Karli i Madh: Aheni më pëlqen, sidomos burimet. Ngrohtësia më bën mirë. Po ju? Sa kohë keni në Ahen?
Andreas: Kam një vit.
Karli i Madh: Po si është Aheni sot?
Andreas: Ju jeni shumë i famshëm, edhe sot!
Karli i Madh: Ashtu?
Andreas: Në Ahen ndodhet shatërvani Karlsbrunnen.
Karli i Madh: Ky është një nder për mua.
Andreas: Ekziston çmimi Karli i Madh.
Karli i Madh: Çmimi Karli i Madh?
Andreas: Po, për unitetin e Evropës.
Karli i Madh: Ah, Evropa! (ai entuziazmohet) Unë kam patur kontakte të mira me të gjithë botën, Konstantinopoja ...

Mësimi 20

Unë kam rezervuar një dhomë

Zonja Berger e pyet Andrean si e kaloi fundjavën me prindërit. Ai i tregon se shkuan për të parë "Operën për dy grosh".

Andreas: Mirëdita, zonja Berger.
 Frau Berger: Mirëdita, zoti Shefer. Atëherë, mirë kalove me prindërit.
 Andreas: Po, faleminderit! Kaluam shumë mirë.
 Frau Berger: Çfarë bëtë?
 Andreas: U tregova prindërve Ahenin.
 Frau Berger: Dhe? A u pëlqeu?
 Andreas: Kështu besoj. Ne shkuam edhe në teatër. Pamë “Operën për dy grosh”.
 Ex: Unë jo!
 Frau Berger: Oh, përsëri zëri juaj i dytë. Po ajo nuk qe me ju?
 Ex: Jo, për fat të keq, jo!

Një klient ka rezervuar një dhomë. Por ai ka gabuar datën dhe e ka rezervuar dhomën për të nesërmen.

Andreas: Mirëdita.
 Herr Müller: Mirëdita. Unë kam rezervuar një dhomë.
 Andreas: Si quheni, ju lutem?
 Herr Müller: Myler, dr. Martin Myler.
 Andreas: Po, unë kam biseduar në telefon me sekretaren tuaj. Prisni pak, ju lutem. (Andrea shfleton regjistrin e hotelit) Dhoma 20. Por ... ju e keni rezervuar dhomën vetëm për nesër. Dhe hoteli për fat të keq sot është plot.
 Herr Müller: Si? E pamundur! Kjo duhet të jetë gabim.
 Andreas: Më vjen keq, dr. Myler. Unë e kam shënuar rezervimin tuaj për në katërbëdhjetë.
 Herr Müller: Për në katërbëdhjetë?
 Andreas: Po! Dhe sot është vetëm trembëdhjetë.
 Herr Müller: Po, është e qartë – këtë e di edhe unë. (psherëtin) Trembëdhjeta është ditë ters. Po ç’ të bëj unë tani?
 Andreas: Prisni një moment, ju lutem. Unë do të bisedoj me shafen.
 Herr Müller: Ju faleminderit. (me vete) Ç’ budallallëk!

Mësimi 21

Si mund të shkoj në postë?

Zoti Myler dëshiron të shkojë në Eurogress, në qendrën e kongreseve në Ahen. Por ai nuk shprehet qartë sa duhet.

Andreas: Mirëmëngjes, dr. Myler.
 Herr Müller: Mirëmëngjes.
 Andreas: Keni fjetur mirë?
 Herr Müller: Po, faleminderit. Shumë mirë. Më thoni: si të shkoj deri në qendër të qytetit?
 Andreas: Ju me siguri doni të shikoni Bashkinë dhe Katedralen?
 Herr Müller: Jo, më falni, unë doja të shkoja në qendrën e kongreseve.
 Andreas: A, kështu, ju doni të thoni në Eurogress?

Herr Müller: Po, pikërisht. Unë dua të shkoj në Eurogress.
Andreas: Ai nuk është larg. Atje mund të shkoni me autobus.
Herr Müller: Oh, jo. Më porositni një taksi, ju lutem.
Andreas: Po, me gjithë qejf.

Një grua e pyet Andream se si mund të shkojë në Theaterplatz (Sheshi i teatrit).

Gruaja: Më falni, dua të shkoj në Theaterplatz. Si mund shkoj atje?
Andreas: Nuk është larg. Mund të shkoni në këmbë.
Gruaja: Sa mirë!
Andreas: Në fillim do të ecni djathtas, pastaj prapë djathtas, pastaj gjithmonë drejt. Kështu arrini direkt në Theaterplatz.
Gruaja: Shumë faleminderit.

Një djalë i ri kërkon të dijë se si shkohet në postë.

Burri: Si të shkoj deri në postë? A ka këtu afër?
Andreas: Po. A e dini rrugën deri në stacionin e trenit?
Burri: Po.
Andreas: Mirë, atëherë shkoni thjesht në stacion. Atje ka një postë.
Burri: Ju faleminderit.

Edhe Eksa e padukshme dëshiron të rregullojë flokët e saj të padukshme në një floktore.

Ex: A ka këtu afër ndonjë floktore?
Andreas: Ku do të shkosh ti?
Ex: Te floktarja.
Andreas: (psherëtin)

Mësimi 22

Të mërkurën, në orën shtatë të mëngjesit

Një grua ankohet te Andrea se dushi i dhomës së saj nuk funksionon.

Gruaja: Mirëmëngjes. Doja të flisja me shefin.
Andreas: Mirëmëngjes. Një moment, ju lutem. (Andrea ngrihet dhe thërret) Zonja Berger? Hanna, te ti është zonja Berger?
Hanna: Jo. Ajo kishte dhimbje dhëmbi. Është te dentistja.
Andreas: (kthehet) Më vjen keq. Shefja nuk është aty. Ndoshta mund t'ju ndihmoj unë?
Gruaja: Kështu shpresoj. Dushi në dhomën time është i prishur.
Andreas: Na falni. Nuk e kishim vënë re.
Gruaja: Gjithë natën ka pikuar. Dhe në mëngjes gjithçka ishte lagur.
Andreas: Do të njoftoj shefen. Do ta rregullojmë, natyrisht.

Gruaja: Këtë shpresoj edhe unë. Mirupafshim.
Andreas: Mirupafshim.

Zonja Berger kthehet nga dentisti. Ajo i telefonon një firme, për të caktuar kohën për rregullimin e difektit.

Burri: Firma Mol, mirëdita.
Frau Berger: Mirëdita, jam Berger, hotel Evropa. Te ne është prishur një dush. Kur mund të vijë ndonjëri prej jush?
Burri: Pa prisni: sot është e hënë, ta lëmë për të premtën, në orën nëntë.
Frau Berger: Oh, jo. Kjo është shumë vonë. Nuk mund të bëhet më shpejt? Është shumë urgjente.
Burri: Të mërkurën, në orën shtatë të mëngjesit.
Frau Berger: Nuk mund të bëhet sot ose nesër?
Burri: Mirë, ta lëmë nesër, por vetëm në mbrëmje.
Frau Berger: Jeni shumë i sjellshëm. Atëherë, për nesër.

Mësimi 23

Ç'ka ndodhur pra?

Andrea i telefonon më në fund dr. Tyrmanit, që e kishte ftuar para shumë kohësh në Berlin. Andrea mëson se tani dr. Tyrmani do të vijë vetë në Ahen.

Dr. Thürmann: Tyrman.
Andreas: Mirëmbrema, dr. Tyrman. Jam Andrea Shefer i hotel Evropës.
Dr. Thürmann: Oh, po! Mirëmbrema, zoti Shefer.
Andreas: Nuk ju kam telefonuar për një kohë të gjatë. Më falni, ju lutem.
Dr. Thürmann: S'ka gjë. S'prish punë!
Andreas: Ju më patët ftuar në Berlin ...
Dr. Thürmann: Po është e vërtetë. Ju kam ftuar. Por vetëm se tani do të vij unë në Ahen.
Andreas: Shumë mirë. Në hotel Evropa ka gjithnjë një dhomë të lirë për ju.
Dr. Thürmann: E di. Por më duhet të shkoj në klinikë.
Andreas: Ah, për këtë më vjen keq.

Dr. Tyrmani i shpjegon se ka patur një aksident me makinë. Por ai nuk ka pësuar gjë të rëndë.

Dr. Thürmann: Kam pasur një aksident.
Andreas: Me makinë?
Dr. Thürmann: Po.
Andreas: A pësua gjë?
Dr. Thürmann: Jo, nuk ndodhi ndonjë gjë e madhe.
Ex: Çfarë ndodhi pra?
Dr. Thürmann: Si, ju lutem? Ky ishte zëri juaj?

Andreas: (i hutuar) Jo, pra ç'ndodhi?
 Dr. Thürmann: Unë po kthehesha nga një mik. Po udhëtoja për në shtëpi – dhe atëherë ... Po këtë unë mund t'ua tregoj në Ahen.

Andreas: Me gjithë qejf.
 Dr. Thürmann: Ejani për të më vizituar në klinikë. Unë do të jem në klinikën e riaftësimit.

Andreas: Do t'ju vizitohet, sigurisht.
 Ex: Edhe unë gjithashtu.
 Andreas: Mirupafshim.
 Dr. Thürmann: Mirupafshim së shpejti në Ahen.

Mësimi 24

Kam harruar për këtë.

Andrea viziton dr. Tyrmanin në një klinikë të Ahenit. Dr. Tyrmani tregon për aksidentin e tij.

(Andrea troket në derën e dhomës së dr. Tyrmanit)

Dr. Thürmann: Po, ju lutem.
 Andreas: Mirëdita, dr. Tyrman.
 Dr. Thürmann: Mirëdita, zoti Shefer.
 Andreas: Si jeni?
 Dr. Thürmann: Mirë! Shumë mirë! Por është pak e mërzitshme këtu!
 Andreas: Si ndodhi ky aksident?
 Dr. Thürmann: Nuk jua kam treguar?
 Andreas: Po. Ju po ktheheshit nga një mik dhe po shkonit në shtëpi. Po ç'ndodhi më vonë?
 Dr. Thürmann: Po – unë u ndala para një semafori – ishte dritë e kuqe, natyrisht.
 Andreas: Dhe pastaj?
 Dr. Thürmann: Makina pas meje ecte shumë shpejt, shoferi nuk frenoi në kohë dhe u përplas.
 Andreas: Po ju? Çfarë ju ndodhi?
 Dr. Thürmann: Jo ndonjë gjë e madhe. Por tani kam shumë shpesh dhimbje koke. (pauze) Po, kjo është historia ime.

Andrea e pyet dr. Tyrmanin për mjekimin që merr në klinikë. Meqë Eksa përzihet në bisedë, dr. Tyrmani bëhet kurioz.

Dr. Thürmann: Po ju? Si shkoni ju?
 Andreas: Faleminderit, mirë. Por kam pasur shumë pak kohë: puna, studimet, dhe pastaj më erdhën për vizitë prindët.
 Dr. Thürmann: Prandaj s'më keni telefonuar?
 Andreas: Hm, jo. Kam harruar për këtë. Më vjen keq.
 Dr. Thürmann: E dini, ju më keni zhgënjyer pak. Por kjo nuk prish shumë punë.
 Andreas: Si ju mjekojnë për dhimbjen e kokës?
 Dr. Thürmann: Natyrisht, më bëjnë shumë masazhe dhe pastaj: burimet. Ngrohtësia më bën mirë.

Ex: Këtë e ka thënë edhe Karli i Madh!
 Dr. Thürmann: Karli i Madh? Unë s'dëgjoj mirë, por ky s'ishte zëri juaj, zoti Shefer?
 Andreas: Jo, ky s'ishte zëri im.
 Ex: Isha unë!
 Dr. Thürmann: Besoj se edhe ju duhet të më tregoni një histori.

Mësimi 25

Mund të më jepni edhe disa peshqirë?

Një grua kërkon që Andrea të porositë një taksi për të.

Gruaja: Mund të më porositni një taksi?
 Andreas: Po, me gjithë qejf. Por për kur?
 Gruaja: Për në çast, ju lutem.
 Andreas: Dakord. Do ta porosis menjëherë.

Në një dhomë mungojnë peshqirët. Klienti kërkon nga zonja Berger që t'ia sjellin.

Burri: Më falni, a mund të jepni edhe disa peshqirë? Në banjë s'ka.
 Frau Berger: Më falni, ju lutem. Sot ka shumë mungesa. Pastruesja e dhomës do t'ju sjellë peshqirë menjëherë. Hana? Hana!
 Hanna: Urdhëro?
 Frau Berger: Çoji të lutem zotit Braun edhe disa peshqirë.
 Hanna: Oh, i harrova. Po ia çoj menjëherë.

Andrea dhe zonja Berger më në fund gjejnë kohë të bisedojnë për dr. Tyrmanin.

Frau Berger: Ah, po, i telefonova dr. Tyrmanit.
 Andreas: Ashtu? Pra, në klinikë ai mërzitet shumë.
 Frau Berger: Po, edhe mua këtë më tha. Prandaj unë e ftova për të dielën.
 Andreas: Ashtu?
 Frau Berger: Do të bëjmë bashkë një shëtitje me anije. Doni të vini edhe ju?
 Ex: Shëtitje me anije?
 Frau Berger: Pikërisht. Edhe zëri juaj i dytë mund të vijë.
 Ex: Kjo vetëkuptohet! Andrea, të lutem!

Mësimi 26

Udhëtimi për te Lorelaj është i mrekullueshëm

Andrea, zonja Berger, dr. Tyrmani dhe Eksa takohen në një mol mbi Rin. Ata duan të bëjnë së bashku një shëtitje në Rin, një lumë shumë i madh që përshkon ndër të tjera edhe Këlnin.

Andreas: Ka shumë njerëz që presin!
 Dr. Thürmann: S'është çudi me këtë kohë të mirë!
 Andreas: Shpresojmë se do të ketë ende vende.
 Frau Berger: Me siguri! (duke psherëtirë) Ah, udhëtimi për te Lorelaj është thjesht një mrekulli.
 Ex: Lorelaj? Unë e njihja. (ëndërrimtare) Ajo ishte shumë e bukur.
 Dr. Thürmann: (me vete) Përsëri ky zë ... (i drejtohet Andreas) Ky nuk ishte zëri juaj, zoti Shefer, apo jo?
 Frau Berger: Oh, jo! Ishte zëri i tij i dytë!
 Dr. Thürmann: Nga vjen ky zë?
 Frau Berger: (ironike) Ky është sekret i zoti Shefer. (Duke iu drejtuar Eksës së padukshme) Atëherë, ti sekret, e di ti edhe këngën e Lorelajt?
 Ex: Jo.
 Frau Berger: Atëherë, dëgjo mirë!

(Ajo këndon këngën e Lorelajt)

Anija kalon pikërisht para shkëmbit të Lorelajt dhe kapiteni i anijes tregon legjendën e Lorelajt.

Burri: Dhe tashti, në të djathtë ne shohim Lorelajn. Shikojeni mirë shkëmbin. Atje ishte ajo, Lorelaj! Ajo ishte shumë e bukur, e mahnitshme. Shumë, shumë lundërtarë e kanë parë ... një herë dhe kurrë më. Mos ndoshta po e shihni edhe ju?

Më tej Andrea mëson se në një shpellë kane banuar dikur *Heinzelmannchen* (Shpirtrat e Mirë të Këlnit). Ai kërkon më shumë hollësi nga Eksa, por më kot.

Burri: Në këtë shkëmb dikur kishte një shpellë. Dhe aty thuhet se kanë banuar *Heinzelmannchen*, Shpirtrat e Mirë të Këlnit.
 Andreas: Eksa, e dije ti këtë?
 Ex: (kruan fytyrën pa u përgjigjur)
 Andreas: Eksa, të pyeta për diçka!
 Ex: (Eksa nuk përgjigjet)
 Andreas: Ke qenë atje më parë? Prej andej vjen ti? Eksa, i njeh ti Shpirtrat e Mirë të Këlnit? (Eksa, nuk përgjigjet). Eksa, ku je? Eksa, nuk të dëgjoj! Eksa!!
 Frau Berger: Ç'ka ngjarë?
 Andreas: Më duket se Eksa ka ikur.